VENDIM
Nr.1212, datë 11.12.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT "MASTER I NIVELIT TË PARË", NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË DHE ARSIMIN E MESËM, NË UNIVERSITETIN "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, të programeve të studimit "Master i nivelit të parë" në:

a) "Mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte";

b) "Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte";

c) "Mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi";

ç) "Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm në lëndën histori";

d) "Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi".

2. Programet e studimeve "Master i nivelit të parë" realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe "Master i nivelit të parë", në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte	50;
b) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte	50;
c) Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi	60;
ç) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori	60;
d) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi	60.

5. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

a) "Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët

edukim fizik dhe sporte” 40 000 lekë;

b) “Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte” 45 000 lekë;

c) “Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi” 40 000 lekë;

ç) “Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori” 45 000 lekë;

d) “Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi”. 45 000 lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 4, të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berish